REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 293, Datë 20.10.2026

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT VJETOR TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2020 DHE 2021, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 00-2026-3430 (233), DATË 27.04.2026, TË KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike";* nenit 142, pika 3, të Kushtetutës; neneve 113 dhe 144, të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017 *"Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi"*, i ndryshuar; Vendimit nr. 00-2026-3430 (233), datë 27.04.2026, të "*Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë"*; nenit 22 të ligjit nr. 7/2017 *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*; dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 368/5 prot., datë 16.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, *"Mbi përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2020 dhe 2021, në zbatim të vendimit nr. 00-2026-3430 (233), datë 27.04.2026, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë",*

Konstatoi se:

- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2026-3430 (233), datë 27.04.2026, pranoi padinë e shoqatës "Albania Renewable Energy Association" (AREA) dhe shfuqizoi aktet si vijon;
  (i) VKM-n nr. 396, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi" si dhe;

  *(ii) Vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 08.06.2020 "Mbi përcaktimin e çmimit të aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020"., *

(iii) Vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 20.01.2021 "Mbi përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021".

- Nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë rezulton se paligjshmëria e VKM-së nr. 396/2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi' lidhej me mosrespektimin e kërkesave ligjore për konsultimin me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, mungesën e një analize të mjaftueshme mbi kriteret e ndryshimit të bonusit, cenimin e parimit të proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike, si dhe tejkalimin e autorizimit ligjor në përcaktimin e afatit për ERE-n.

- Nga analiza e vendimit të Gjykatës së Lartë rezulton se *në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr. 7/2017 i shfuqizuar* (ligji ne fuqi në kohën e shqyrtimit gjyqësor) dhe aktualisht në mbështetje të nenit 10, pika 4, të ligjit nr. 24/2023, *"Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"*, përcaktohet qartë se; ERE është organi kompetent për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Për rrjedhojë, vlerësojmë se ERE ka kompetencë të kryejë vlerësimin rregullator dhe financiar të pasojave të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të shqyrtojë nevojën për ndërhyrje në vendimet e tjera të miratuara prej saj, duke vlerësuar bazën ligjore të secilit akt dhe ndikimin konkret të shfuqizimit të VKM-së nr. 396/2020, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Për sa u përket vendimeve të ERE-s, që lidhen me *"Përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi"* për vitet 2023, 2024 dhe 2025, vlerësohet se nuk rezulton e nevojshme ndërhyrja për ndryshimin ose shfuqizimin e tyre. Këto vendime kanë përcaktuar çmimin prej 10 lekë/kWh, në zbatim të kufirit maksimal të parashikuar nga VKM-ja nr. 67/2023, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Lartë ka shfuqizuar shprehimisht VKM-në nr. 396/2020 dhe vendimet e ERE-s nr. 94/2020 dhe nr. 16/2021.

- Për rrjedhojë, për sa kohë që çmimi i miratuar për vitet pasardhëse nuk rezulton i ndikuar nga ndryshimi i bonusit të përcaktuar me VKM-në nr. 396/2020, nuk evidentohen shkaqe ligjore që të kërkojnë rishikimin e këtyre vendimeve, pa cenuar detyrimin për respektimin e vendimit gjyqësor dhe të kuadrit ligjor në fuqi.

- Në vijim të vendimit të Gjykatës së Lartë, për qëllim të analizës së historikut të çmimeve të përcaktuara me vendimet përkatëse të ERE-s, janë kryer përllogaritjet për secilin prej vendimeve të analizuara, duke marrë në konsideratë të dhënat dhe parametrat e përdorur për përcaktimin e çmimit në secilin vit sipas vendimeve përkatëse konform formulës "Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të

energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit".

- Aplikimi i bonusit në masën 1.30 do të afektonte vetëm vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 08.06.2020. Me qëllim përllogaritjen e efektit financiar që rezulton nga kjo diferencë për vitin 2020 janë marrë në konsideratë sasitë e prodhimit total nga Hec-et të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes të OSHEE sh.a. dhe të prodhuar nga Hec-et në rrjetin e transmetimit për OSHEE sh.a. (sipas raportit vjetor të përcjellë prej OSHEE Bilanci Blerjes vjetor 2020).

- Për muajin qershor 2020, për shkak se çmimi është bërë i aplikueshëm duke filluar nga data 12.06.2020, sasia e energjisë elektrike është përcaktuar në bazë të një përllogaritjeje proporcionale. Për këtë qëllim, është marrë në konsideratë sasia mesatare ditore e energjisë dhe është shumëzuar me numrin e ditëve të periudhës gjatë së cilës çmimi ka qenë i aplikueshëm. Sasia e konsideruar e energjisë është mesatarisht 343,114,620 kWh *(sipas raportit vjetor të përcjellë prej OSHEE Bilanci Blerjes vjetor 2020)*. Mbi këtë sasi është aplikuar diferenca ndërmjet çmimit të përllogaritur duke konsideruar bonusin në masën 1.30 dhe çmimit sipas vendimit nr. 94, datë 08.06.2020. Përllogaritja e efektit financiar paraqitet perllogaritjen si më vijon: *Efekti financiar: 343,114,620 kWh × 0.60522 Lekë/kWh = 207,659,830 Lekë.*

- Pavarësisht përllogaritjes së efektit financiar mbi bazën e sasisë së humbjeve të evidentuara nga raportimet që disponojmë , FTL sh.a., duhet të rakordojë sasitë dhe faturat që i përkasin periudhës qershor – dhjetor 2020 për secilin prodhues, duke dokumentuar përfituesit dhe subjektet përgjegjëse për pagesën, të cilët kanë statusin e prodhues ekzistues me përparësi apo tashmë kanë dalë në treg të lirë prej vitit 2020, pasi mund ti ketë përfunduar periudha 15 vjeçare e mbështetjes. Me qëllim kryerjen e një vlerësimi sa me të drejtë dhe transparent shoqëria FTL sh.a., duhet të kryejë rakordimet mbi sasitë dhe faturat për secilin prodhues të energjisë elektrike i cili afektohet nga ky vendim dhe të njoftojë ERE-n për korrigjimet e kryera.

- Për sa më sipër argumentuar, vlerësojmë se shfuqizimi i VKM-së nr. 396/2020 dhe i vendimeve të ERE-s nr. 94/2020 dhe nr. 16/2021 ka lënë pa akt të vlefshëm përcaktimin e çmimit për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitet 2020 dhe 2021. Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Lartë, dhe legjislacionit ne fuqi vlerësojmë se ERE ka kompetencën te përcaktoje çmimin me një vendim të ri, duke u mbështetur në VKM-në nr. 687/2017, e cila mbetet në fuqi. Në vijim, OSHEE sh.a., duhet të marri masat e nevojshme dhe të korrigjojë faturat përkatëse për energjinë e blerë nga këta prodhues gjatë periudhës së prekur ne përputhje me llogaritje e parashikuara me sipër.

Për gjithë sa me sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI

1. Përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020 prej 8.0532 lekë/kWh.

2. Përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021 prej 7.448 lekë/kWh.

3. FTL sh.a., të rakordojë sasitë dhe faturat për secilin prodhues të energjisë elektrike që afektohet nga ky vendim, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Rakordimi të dokumentohet për çdo prodhues, duke evidentuar sasitë e energjisë elektrike, çmimet e aplikuara në faturimin fillestar, diferencat e çmimit dhe vlerat financiare që rezultojnë, në përputhje me dokumentacionin përkatës.

5. FTL sh.a., të raportoj pranë ERE-s për korrigjimet e kryera dhe gjendjen e likuiditetit dhe modalitet e shlyerjes së pagesave për prodhuesit me përparësi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

6. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI